

Vendim nr. 117 datë 30.05.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Illir Toska,	Anëtar

në datën 30.05.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5 (G) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **GAZMIR DACI**, përfaqësuar me prokurë nga avokat Ilir Murati.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-419, datë 09.03.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 15, pika 2, 17, 18, 33, pika 1, 43, 44, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 135, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur në gjykatë kërkesë për gjykimin e të pandehurit Gazmir Daci (*kërkuesi*). Gjykimi i çështjes është zhvilluar

me procedurën e gjykimit të shkurtuar dhe në përfundim Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3638, datë 24.11.2016, ka vendosur të shpallë fajtor kërkuesin për veprat penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, “Prodhimi dhe mbajtja e armëve luftarake”, “Kanosja” dhe “Falsifikimi i letërnjoftimeve ose vizave”, të parashikuara respektivisht nga nenet 79, shkronja “dh”, 278, 189, paragrafi 1 dhe 84 të Kodit Penal (KP). Në bazë të nenit 55 të KP-së, gjykata e ka dënuar kërkuesin me një dënim të vetëm, burgim të përjetshëm. Në zbatim të neni 406, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale (KPP), gjykata e ka ulur dënimin me një të tretën dhe kërkuesi është dënuar përfundimisht me 35 vjet burgim. Kundër vendimit kërkuesi ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit.

2. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1263, datë 22.09.2017, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimin e akuzës për veprën penale “Kanosja” dhe lënien në fuqi të vendimit për pjesën tjetër të tij. Kundër vendimit ka ushtruar rekurs kërkuesi, duke kërkuar prishjen e vendimeve të gjykatave të faktit për sa i përket masës së dënimit me burgim të përjetshëm dhe caktimin e një dënimi tjetër më të drejtë dhe më të përshtatshëm.

3. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka shqyrtuar rekursin e kërkuesit në dhomën e këshillimit dhe me vendimin nr. 00-2023-419, datë 09.03.2023 ka vendosur mospranimin e tij, pasi nuk ekzistonin shkaqet ligjore të parashikuara në nenin 432, pika 1, të KPP-së.

4. Në datën 24.04.2024, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuesit

5. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

5.1. *E drejta e aksesit në gjykatë*, pasi Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit pa praninë e të pandehurit dhe të avokatit të zgjedhur prej tij ose ndonjë mbrojtësi tjetër. Për më tepër, ajo gjykatë nuk i ka njoftuar palët për të paraqitur parashtrimet me shkrim. Gjithashtu, njoftimi nuk është bërë përmes shpalljes publike dhe as nuk i është njoftuar mbrojtësit të kërkuesit me *e-mail*. Në këtë mënyrë është cenuar edhe *parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, si dhe e drejta për t`u mbrojtur dhe për t`u dëgjuar*.

5.2. *Parimi i individualizimit të dënimit penal dhe proporcionalitetit*, pasi gjykatat e faktit, por edhe Gjykata e Lartë nuk kanë arsyetuar në vendimet e tyre se pse nuk është pranuar kërkesa e kërkuarit për të caktuar një dënim nën apo në minimumin e parashikuar me ligj dhe as nuk kanë argumentuar se pse e kanë dënuar kërkuarin me maksimumin e parashikuar nga ligji penal. Gjykatat nuk kanë caktuar një dënim të drejtë dhe në përpjesëtim me veprën në rastin e kërkuarit.

5.3. *Parimi i sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Lartë në rastin konkret ka mbajtur qëndrim të ndryshëm për çështje të së njëjtës natyrë, duke iu referuar vendimit unifikues nr. 3, datë 02.11.2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë lidhur me individualizimin e dënimit. Ky qëndrim është në kundërshtim edhe me jurisprudencën kushtetuese.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkuarit

6. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuari të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

7. Kërkuari, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

8. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi. Në kushtet kur kontrolli kushtetues ka një funksion *subsidiar*, ai mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar të çfarëdolloj forme që përmbyll procesin gjyqësor të themelit (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Kolegji konstaton se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

9. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastet e kundërshtimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës së Lartë, Gjykata e ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor duke filluar nga data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në rastin konkret, Kolegji vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi ka përfunduar me vendimin e datës 09.03.2023 të Gjykatës së Lartë. Sipas informacionit të kësaj të fundit, përcjellë në rrugë elektronike, vendimi është publikuar në faqen zyrtare të asaj gjykate në datën 16.05.2023, ndërkohë që ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 24.04.2024, pra pas më shumë se 11 muajve. Kërkuesi, si argument në mbështetje të plotësisimit të këtij kriteri të pranueshmërisë, ka parashtruar se ka marrë dijeni për vendimin e Gjykatës së Lartë në datën 22.02.2024, kur ajo gjykatë i ka dërguar informacionin e kërkuar prej tij lidhur me statusin e çështjes penale në ngarkim të tij, duke i bashkëlidhur edhe një kopje të vendimit nr. 00-2023-419, datë 09.03.2023 të Kolegjit Penal.

11. Gjykata ka theksuar se fakti që kërkuesi është i izoluar për shkak të vuajtjes së dënimit me burgim, është një rrethanë që e vështirëson marrjen dijeni për vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë nga njoftimi me shpallje (*shih vendimin nr. 14, datë 21.06.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithsesi, Kolegji mban në konsideratë faktin se procesi gjyqësor në Gjykatën e

Lartë është vënë në lëvizje prej vetë kërkuessit, nëpërmjet mbrojtësit të zgjedhur prej tij, ndaj ai kishte interesin dhe mundësitë për të ndjekur fatin e ankimit të tij. Nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se më 07.02.2023 është publikuar në faqen zyrtare të asaj gjykate lista e çështjeve penale për shqyrtim në dhomën e këshillimit, ku përfshihej edhe çështja e kërkuessit. Po ashtu, detajet e çështjes së kërkuessit, përfshirë datën e numrin e vendimit, statusin e çështjes “mbyllur” dhe një kopje të vendimit objekt kundërshtimi, rezultojnë të publikuara edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë. Për më tepër, Kolegji konstaton se në rekursin e paraqitur bashkëlidhur kërkesës nuk rezulton që avokati i kërkuessit të jetë kujdesur për të shënuar të dhënat elektronike të kontaktit, me qëllim realizimin e njoftimeve nga sekretaria e asaj gjykate, çka do të mundësonte njoftimin e drejtpërdrejtë të tij edhe për vendimmarrjen e saj.

12. Në kontekstin e këtyre rrethanave, argumentet e kërkuessit se është njohur me vendimin e Gjykatës së Lartë kur është interesuar për të marrë informacion pranë saj, në kushtet kur ai nuk ka paraqitur ndonjë provë ose pretendim për pamundësinë e marrjes dijëni nga ai ose mbrojtësi i zgjedhur prej tij të vendimit të arsyetuar dhe të disponueshëm për palët, nuk janë të mjaftueshme për të provuar në nivel kushtetues se kjo është data e marrjes dijëni për vendimin e kundërshtuar, për sa kohë që një informacion i tillë mund të kërkohej në çdo rast dhe në çdo ditë kur një palë ndërgjyqëse kërkon të pajiset me një kopje të vendimit gjyqësor.

13. Nga sa më lart, duke analizuar argumentet e paraqitura nga kërkuessi në raport me standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese, Kolegji çmon se kërkuessi nuk ka arritur të provojë në nivel kushtetues se ka marrë dijëni në një datë të ndryshme nga data në të cilën vendimi i Gjykatës së Lartë është bërë i disponueshëm për palët. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual është paraqitur jashtë afatit 4-mujor të përcaktuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000.

14. Në kushtet kur kriteri paraprak për legjitimimin *ratione temporis* nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterit *ratione materiae* bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

15. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.